



Instituti Demokratik i Kosovës  
Kosova Democratic Institute  
[www.kdi-kosova.org](http://www.kdi-kosova.org)

# DECENTRALIZIMI


**NË KOSOVË**

**Përvojat nga Komunat e Rajonit të Prizrenit**

# DECENTRALIZATION

**IN KOSOVA**

**Experiences from Municipalities of Prizren Region**



Dhjetor - December 2009



## STAFI

**Ismet KRYEZIU** - Drejtor Ekzekutiv  
email: ikryeziu@kdi-kosova.org

**Vjollca VOGËL** - Menaxhere e administratës dhe financave  
email: vjollca@kdi-kosova.org

**Leonora CIKAJ** - Asistente për administratë dhe financa  
email: lcikaj@kdi-kosova.org

**Emine BEHLULI** - Asistente për administratë dhe financa  
email: ebehluli@kdi-kosova.org

### PROGRAMI - QEVERISJA QENDRORE

**Valmir ISMAILI** - Menaxher programi  
email: vismaili@kdi-kosova.org

**Driton SELMANAJ** - Asistent i programit  
email: dselmanaj@kdi-kosova.org

**Fitore ZENELI** - Asistente e programit  
email: fzeneli@kdi-kosova.org

**Isuf ZEJNA** - Monitorues  
email: izejna@kdi-kosova.org

**Ramadan KLISURICA** - Monitorues  
email: rklisurica@kdi-kosova.org

**Rrezarta AHMETI** - Monitorues  
email: rrahmeti@kdi-kosova.org

### PROGRAMI - QEVERISJA LOKALE

**Naim CAHANAJ** - Menaxher programi  
email: ncahanaj@kdi-kosova.org

**Nora VESELI** - Koordinatore  
email: ncahanaj@kdi-kosova.org

### PROGRAMI - TRANSPARENCA DHE ANTI-KORRUPSIONI

**Merita MUSTAFA** - Menaxhere e programit  
email: mmustafa@kdi-kosova.org

**Admir ISTREFI** - Asistent i programit  
email: aistrefi@kdi-kosova.org

**Besnik RAMADANAJ** - Zyrtar për marrëdhënie me publikun  
email: bramadanaj@kdi-kosova.org

**Sahit BIBAJ** - Avokat / Këshilltar juridik  
email: sbibaj@kdi-kosova.org

**Natyra KASUMAJ** - Vullnetare  
email: nkasumaj@kdi-kosova.org

**Visar RAMAJ** - Vullnetar  
email: vramaj@kdi-kosova.org

### BASHKËPUNËTOR TË JASHTËM

**Arsim GJINOVCI** - IT & design  
email: agjinovci@kdi-kosova.org

**www.kdi-kosova.org**  
email: info@kdi-kosova.org

## Përmbajtja

Hyrje.....	4
Metodologjia.....	4
Decentralizimi: kontesti politik dhe pasqyrë e shkurtër kronologjike.....	4
Korniza Ligjore që Rregullon Decentralizimin.....	6
Arsimi dhe Edukimi.....	10
Ekonomia dhe Financat.....	12
Pavarësia financiare e Komunave.....	12
Shërbimet Publike.....	13
Shëndetësia.....	13
Planifikimi Rural dhe Urban.....	15
Zhvillimi Ekonomik Lokal.....	15
Administrata Komunale.....	16
Mbrojtja e Mjedisit Lokal.....	17
Organizimi Territorial sipas Legjislacionit të Ri.....	18
Ligji mbi Zgjedhjet Lokale.....	18
Ligji për Financat e Pushtetit Lokale.....	18
Konkluzione dhe Rekomandime.....	19
Lista e burimeve të shfrytëzuara .....	20

## 1. HYRJE

### Metodologjia

Hulumtimi i kësaj analize është i bazuar në infrastrukturën ligjore që ka përcjellë decentralizimin si dhe duke mbledhur të dhëna prej burimeve të ndryshme si nga organizatat vendore ashtu edhe ato ndërkombëtare. Po ashtu një pjesë e burimit të informacionit është marrë nga intervistat me zyrtarët e qeverive lokale në regjionin e Prizrenit. Gjithashtu janë konsultuar edhe raportet e ndryshme të publikuara në fushën e decentralizimit. Për bazë është marrë edhe Plani i Veprimit për decentralizim i përpiluar nga MAPL.

Në kuadër të analizës lidhur me çështjet specifike të fushës së decentralizimit mund të gjenden jo vetëm sfidat me të cilat përballen administratat komunale të rajonit të Prizrenit dhe praktikatat e mira, por edhe rekomandimet të cilat pritet të adaptohen me qëllim të rritjes së performancës së administratës publike dhe rritjes së cilësisë së shërbimeve me qëllim të përfarimit të komunës me qytetarë.

### DECENTRALIZIMI: KONTEKSTI POLITIK DHE PASQYRË E SHKURTËR KRONOLOGJIKE

Procesi i reformimit të pushtetit lokal dhe decentralizimit përbën një proces shumë kompleks që ngërthen në vete elemente politike, socio-ekonomike, të qeverisjes, të politikave, administrative, buxhetore, etj, pra kërkon themelimin e komunave të reja, bartjen graduale të kompetencave nga institucionet qendrore në pushtetin lokal, gjë që kërkon ngritjen e kapaciteteve institucionale për vetëqeverisje lokale efektive, përfshirë reformimin e sistemit të financave lokale. Para së gjithash, themelimi dhe vënia në funksion e një sistemi të tillë kompleks të qeverisjes kërkon krijimin e një baze ligjore precize dhe të qëndrueshme, gjë që përfshin dispozita kushtetuese, ligje të reja dhe akte nënligjore për zbatimin efektiv të ligjeve, akte këto si të qeverisë qendrore ashtu edhe të vetë Komunave, varësisht nga rrethanat dhe kompetencat e secilës prej tyre. Krijimi i një sistemi të qëndrueshëm dhe efektiv të vetëqeverisjes lokale në të gjithë territorin e Kosovës pritet të sigurojë shërbime komunale më të shpejta dhe efektive, dhe eventualisht përmirësimin e kushteve të jetesës për të gjithë qytetarët e saj, duke i kushtuar kujdes të veçantë nevojave dhe brengave të komuniteteve jo-shumicë.

Reforma e pushtetit lokal ka filluar pas instalimit të administratës së OKB-së (UNMIK), kryesisht si decentralizim politik<sup>1</sup> me qëllim të integritetit të komunitetit serb në sistemin qeverisës në Kosovë. Decentralizimi u bë prioritet i komunitetit ndërkombëtar në Kosovë sidomos pas trazirave të marsit 2004<sup>2</sup>. Element kyç i dimensionit politik të decentralizimit ka qenë 'krijimi i entiteteve të pavarura politike, komunave, me poli-

<sup>1</sup>The Kosovo Decentralisation Briefing Book, Open Society Institute, Budapest, 2007, fq. 30, [http://lgi.osi.hu/cimg/0/0/7/6/2/decentralization\\_\\_4\\_.pdf](http://lgi.osi.hu/cimg/0/0/7/6/2/decentralization__4_.pdf)

<sup>2</sup>Kosovo: Toëard Final Status, International Crisis Group (ICG), Beograd / Prishtinë / Bruksel, fq. 5, [http://www.crisisgroup.org/library/documents/europe/balkans/161\\_kosovo\\_toward\\_final\\_status.pdf](http://www.crisisgroup.org/library/documents/europe/balkans/161_kosovo_toward_final_status.pdf)

## Decentralizimi në Kosovë:

tikanë të tyre autonomë të zgjedhur<sup>3</sup>. Përkundër frikës se decentralizimi mund të rrezikojë kufijtë territorialë të vendit, për faktin se komuniteti serb deri atëherë kishte bojkotuar tërë procesin politik në Kosovë, dhe akoma ishte politikisht më shumë i integruar në Serbi sesa në Kosovë, kjo kërkesë politike nga ana e komunitetit ndërkombëtar shpejt u bë prioritet i IPVQ-ve, përkatësisht Qeverisë së Kosovës. Në korrik 2004, kjo e fundit formoi një grup punues për këtë qëllim, të kryesuar nga Ministri i Shërbimeve Publike, Jakup Krasniqi, i cili grup hartoi një dokument kornizë për decentralizimin, i cili dokument megjithatë u fokusua vetëm në aspektet politike, pa përcaktuar ndonjë kornizë kohore dhe hapësinore (përkatësisht komunat e reja që duhet të formoheshin). Me intensifikimin e procesit të Standardeve për Kosovën, Qeveria e Kosovës intensifikoi procesin përmes 'pilot-projekteve' për pesë zona territoriale, duke e duke balancuar kështu në aspektin komuniteteve të cilat do të përfitonin nga ky proces: nga pesë pliot-njësitë komunale të propozuara, dy syresh ishin të banuar me shumicë serbe (Graçanica dhe Parteshi), kurse pjesa tjetër me komunitete të tjera (Mamusha me turq, dhe Juniku e Hani i Elezit me shqiptarë).

Përkundër kësaj oferte, pjesëtarët e komunitetit serb vazhduan ta bojkotonin procesin e formimit të pilot-njësiteve komunale, dhe deri në shpalljen e pavarësisë nuk ka pasur ndonjë përparim në formimin e komunave me shumicë serbe, kryesisht për shkaqe politike, përkatësisht të ndikimit të madh të Beogradit zyrtar të serbët e Kosovës, nga njëra anë, dhe mosveprimit të UNMIK-ut vis-a-vis këtij ndikimi. Për pasojë, siç është demonstruar vazhdimisht kur janë mbajtur zgjedhjet e Serbisë në Kosovë, UNMIK-u nuk ka bërë asgjë përtej kundërshtimit retorik të kësaj anomalie. Për rrjedhojë, implementimi i decentralizimit ka vazhduar të zvarritet deri në fillimin e bisedave për statusin final, të cilat filluan në nëntor 2005. Decentralizimi ishte tema e raundit të parë të bisedave për status, të mbajtura në shkurt 2006, me ç'rast delegacioni kosovar u tregua shumë konstruktiv, në veçanti sa i përket lirisë së komunave për lidhje dhe bashkëpunim ndër-komunal dhe ndër-kufitar, në pajtueshmëri me Kartën Evropiane për Vetëqeverisje Lokale. Më tej, ata gjithashtu dhanë garanci se këto premisa do të reflektoheshin shprehimisht në Ligjin e ardhshëm për Vetëqeverisje Lokale<sup>4</sup>.

I tërë rezultati i procesit të negociatave për temën e decentralizimit në kuadër të bisedave për status u reflektua në Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, i cili i kushton një kapitull të tërë këtij procesi. Në këtë mënyrë, dispozitat mbi decentralizimin marrin një rëndësi më fundamentale sesa ligjore, duke u ranguar kështu në nivel 'supra-kushtetues', pasi jo vetëm që dispozitat kyçe të këtij procesi reflektohen në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, por edhe për faktin se Pakoja ka precedencë juridike mbi Kushtetutën<sup>5</sup>. Pika politikisht më e rëndësishme, si për komunitetin serb, por që gjithashtu determinon sistemin politik dhe qeverisës në Kosovë, është themelimi i 5 komunave të reja (Graçanica, Ranillugu, Parteshi, Kllokot/Verbovci dhe Mitrovica e Veriut) si dhe zgjerimi i një

<sup>3</sup>The Kosovo Decentralisation Briefing Book, Open Society Institute, Budapest, 2007, fq. 30, [http://lgi.osi.hu/cimg/0/0/7/6/2/decentralization\\_\\_4\\_.pdf](http://lgi.osi.hu/cimg/0/0/7/6/2/decentralization__4_.pdf)

<sup>4</sup>Po aty, fq. 252

<sup>5</sup>Constitution of the Republic of Kosovo, Kapitulli XIII: Dispozitat Përfundimtare, Neni 143, Kuvendi i Republikës së Kosovës, Prishtinë, qershor 2008, fq. 55 – 56, <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/Constitution1%20of%20the%20Republic%20of%20Kosovo.pdf>

## Përvojat nga Komunitat e Rajonit të Prizrenit

komune (Novobërda)<sup>6</sup>. Përveç kësaj, Pakoja sanksionon edhe katër ligje speciale, përfshirë legjislacionin mbi 'interesat vitale'. Me përfundimin e bisedave për status hyn në fuqi Pakoja e Ahtisaarit, e cila reflekton të gjitha dispozitat e Pakos së Ahtisaarit sa i përket vetëqeverisjes lokale dhe 'interesave vitale', në këtë kontekst. Aktualisht procesi i decentralizimit ka avancuar, të paktën në dimensionin politik, me themelimin e të gjitha komunave të reja të parapara, përveç asaj të Mitrovicës së Veriut.

### Korniza Ligjore e Decentralizimit

Gjatë qeverisjes së UNMIK-ut, qeverisja lokale është rregulluar në bazë të Rregulloreve të UNMIK-ut 2000/45 (dhe rregulloreve pasuese për plotësim-ndryshimin e kësaj) dhe 2007/30, rregullore këtë që ishin baza e funksionimit të qeverisjes lokale dhe përcaktonin kompetencat e Komunave.

Pas hyrjes në fuqi të Pakos së Ahtisaarit, këto rregullore janë zëvendësuar me legjislacion vendor. Siç u theksua më lart, Plani i Ahtisaarit sanksionon një numër ligjesh të obligueshme për Kosovën me qëllim të rregullimit të procesit të decentralizimit, përkatësisht rregullimit të kompetencave ekskluzive dhe speciale të Komunave, përfshirë domenin e 'interesave vitale'. Këto ligje janë: Ligji mbi Vetëqeverisjen Lokale Ligji mbi Zgjedhjet Lokale, Ligji mbi Kufijtë Komunalë, Ligji mbi Menaxhimin e Financave Lokale dhe Ligji mbi Arsimin nëpër Komuna<sup>8</sup>.

Bazuar në Pakon e Ahtisaarit, Kosova tashmë ka evoluar në këtë proces dhe ka arritur të shpallë pavarësinë e saj, ka miratuar Kushtetutën dhe të nxjerrë të gjitha ligjet të cilat i ka paraparë paketa e Ahtisaarit. Andaj si pikë referuese gjatë hartimit të këtij dokumenti do të kemi infrastrukturën complete që përcjellë reformën e qeverisë lokale dhe decentralizimin. Pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, institucionet vendore kanë arritur të miratojnë Kushtetutën dhe ligjet bazike të lartpërmendura për jetësimin e plotë të procesit të decentralizimit.

Ligji për Vetëqeverisje Lokale, si bazë themelore ligjore në këtë drejtim, e përkufizon Komunën si njësi themelore të vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës, e përbërë nga një komunitet i qytetarëve në një territor të caktuar, të përcaktuar me ligj, e cila ushtron tërë pushtetin, i cili nuk është i rezervuar shprehimisht për institucionet qendrore, ndërsa kompetencat komunale i rregullon sipas parimit të subsidiaritetit, ku bëjnë pjesë kompetencat vetanake, kompetencat e deleguara, dhe kompetencat e zgjeruara komunale.

Parimi i subsidiaritetit përdoret për të siguruar që përgjegjësitë publike të ushtrohen nga ato autoritete që janë më të afërtat me qytetarë (neni 4 i Kartës Evropiane për vetëqeverisje lokale).

<sup>6</sup>Comprehensive Proposal for Kosovo Status Settlement, Shtojca III: Decentralizimi, UNOSEC, Vjenë, 2 shkurt 2007, fq. 31 – 32, <http://www.unosek.org/docref/report-english.pdf>

<sup>7</sup>Constitution of the Republic of Kosovo, Kapitulli IV: Kuvendi i Republikës së Kosovës, Neni 81, Kuvendi i Republikës së Kosovës, Prishtinë, qershor 2008, fq. 26 – 27, <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/Constitution1%20of%20the%20Republic%20of%20Kosovo.pdf>

<sup>8</sup>Po aty, Shtojca VII: Agjenda Legjislative, fq. 57 – 58

## Decentralizimi në Kosovë:

Kompetencat komunale vetanake që i parasheh legjislacioni i ri janë kompetenca të plota dhe ekskluzive për interesin lokal, duke respektuar standardet e përcaktuara në legjislacionin e zbatueshëm, në një numër fushash:

- Zhvillimi ekonomik lokal;
- Planifikimi urban dhe rural;
- Shfrytëzimi dhe zhvillimi i tokës;
- Zbatimi i rregulloreve të ndërtimit dhe standardeve për kontrollimin e ndërtimit;
- Mbrojtja e mjedisit lokal;
- Ofrimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve publike dhe shërbimeve komunale, përfshirë furnizimin me ujë, kanalizimin dhe drenazhin, trajtimin e ujërave të zeza, menaxhimin e mbeturinave, rrugëve lokale, transportit lokal dhe skemave të nxehtësie lokale;
- Reagimin ndaj rasteve emergjente lokale;
- Ofrimin e arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm, përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve edukativo-arsimore, punësimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e mësimit dhe administratorëve të arsimit;
- Promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut;
- Ofrimin e kujdesit publik primar shëndetësor;
- Ofrimin e shërbimeve familjare dhe shërbimeve të tjera të mirëqenies sociale, siç është përkujdesja për të cenueshmit, strehimin familjar, përkujdesjen ndaj fëmijëve, përkujdesjen ndaj të moshuarve, përfshirë regjistrimin dhe licencimin e këtyre qendrave të përkujdesjes, punësimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e profesionistëve të mirëqenies sociale;
- Banimin publik;
- Shëndetësinë publike;
- Licencimin e shërbimeve publike dhe objekteve, duke përfshirë ato që kanë të bëjnë me argëtimin, aktivitete kulturore dhe të lira, ushqimin, strehimin, tregjet, shitësit në rrugë, transportimin lokal publik dhe taksitë;
- Emërimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike;
- Ofrimin dhe mirëmbajtjen e parqeve dhe hapsirës publike;
- Turizmin;
- Aktivitetet kulturore dhe të lira;
- Çfarëdo çështjesh që nuk përjashtohen shprehimisht nga kompetenca e tyre, apo që nuk i janë paracaktuar një autoriteti tjetër.

Sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, autoritetet e Republikës së Kosovës mund të delegojnë përgjegjësi në këto fusha:

- Shënimet kadastrale;
- Regjistrimi civil;
- Regjistrimi i votueseve;
- Regjistrimi dhe licencimi i bizneseve;
- Shpërndarja e pagesave të ndihmës sociale (përveç pensioneve);
- Mbrojtja e pyjeve që ndodhen në territorin e komunës në kuadër të autorizimeve të deleguara nga autoriteti qendror, përfshirë dhënien e licencave për prerjen e drunjve, në bazë të rregullave të miratuara nga Qeveria.

Disa komuna, kanë kompetencat e tyre të zgjeruara vetanake në fushën e shëndetë-

## Përvojat nga Komunat e Rajonit të Prizrenit

tësisë, edukimit, kulturës dhe do të kenë të drejtë për të marrë pjesë në zgjedhjen e komandantëve të stacioneve policore.

Autoritetet qendrore në Republikën e Kosovës monitorojnë ushtrimin e kompetencave të zgjeruara në pajtim me legjislacionin qendror, që parasheh qasje të barabartë në shërbimet publike; standarde minimale sasiore dhe cilësore në ofrimin e shërbimeve publike; kualifikime minimale të personelit dhe trajnimit të tyre, parimet e përgjithshme për licencim dhe akreditim të ofruesve të shërbimeve publike<sup>9</sup>.

Sidoqoftë, kompetencat e deleguara, duhet që domosdo në të gjitha rastet të shoqërohen me financim të nevojshëm në përputhje me objektivat e përcaktuar sipas LVL-së dhe Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, gjë që është konfirmuar nga zyrtarët komunalë me rastin e bartjes së kompetencave nga niveli qendror në atë lokal.

Barra e përgjithësime për krijimin e politikave dhe veprimeve për themelimin e komunave të reja dhe implementimin e procesit të decentralizimit bie mbi Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, e cila ka hartuar dhe miratuar Planin e Veprimit për Zbatimin e Decentralizimit 2008 – 2010. Ky plan veprimi parasheh në hollësi të gjithë hapat që do të ndërmerren gjatë kësaj periudhe për reformimin e pushtetit lokal dhe decentralizimit.

Ky plan veprimi pasqyruar synimin strategjik të Qeverisë së Kosovës për krijimin e një sistemi të qëndrueshëm dhe efektiv të vetëqeverisjes lokale në të gjithë territorin e Kosovës, i cili do të sigurojë kushte më të mira për jetesë për të gjithë qytetarët e saj duke i kushtuar kujdes përkatës nevojave të posaçme të komuniteteve jo-shumicë<sup>10</sup>.

Bazuar në këtë plan është formuar Grupi Punues Ndërmintor për Decentralizim (GND), i cili shqyrton projektligjet dhe projektvendimet e hartuara për zbatimin e decentralizimit dhe i dërgon ato për miratim në Qeveri, shqyrton dhe miraton programe dhe projekte për zhvillimin e mëtejshëm të procesit të decentralizimit dhe konsolidimit të vetëqeverisjes vendore, bashkërendon aktivitetin e ministrive dhe institucioneve të tjera qendrore në procesin e formimit të komunave të reja në bashkëpunim me Përfaqësuesin Civil Ndërkombëtar dhe siguron qasje të koordinuar nga ministrinë përkatëse dhe nga komunat ekzistuese, vëzhgon punën e Ekipeve për Përgatitje Komonale (EPK) dhe bën vlerësimin raporteve të progresit për themelimin e komunave të reja, drejton procesin e bartjes së kompetencave dhe kërkon raporte nga ministrinë dhe institucionet e tjera përkatëse për dinamikën e transferimit, bashkërendon përpjekjet për sigurimin e burimeve të nevojshme financiare dhe burimeve të tjera për themelimin e komunave të reja, bashkërendon punën e donatorëve vendorë dhe të huaj në mbështetje të këtij procesi, miraton projekte dhe programe si dhe cakton prioritetet për ndërtimin dhe zhvillimin e kapaciteteve të të zgjedhurve dhe shërbuesve civilë komunalë në përputhje me nevojat që paraqiten nga procesi i decen-

<sup>9</sup>Ligji për Vetëqeverisje Lokale neni 19 ,

[http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008\\_03-L040\\_al.pdf](http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008_03-L040_al.pdf)

<sup>10</sup>Plani I veprimit për Decentralizim 2008-2010 fq 2

<http://www.ks-gov.net/mapl/Documents/Plani%20i%20Veprimit%20per%20Zbatimin%20e%20Decentralizimit-1.pdf>



## Decentralizimi në Kosovë:

tralizimit, zbaton Planin e Veprimit për Zbatimin e Decentralizimit dhe dorëzon raporte periodike në qeveri, shqyrton dhe miraton programe dhe projekte për zhvillimin e mëtejshëm të procesit të decentralizimit dhe konsolidimin e vetëqeverisjes lokale në drejtim të përmbushjes së këtyre objektivave<sup>11</sup>:

Në përputhje me objektivat , GND-ja (Grupi Ndërmintor për Decentralizim) themelon grupe punuese për lëmit që preken nga procesi i decentralizimit. Si rezultat i kësaj nga GND-ja ka të themeluara pesë grupe punuese dhe atë:

- Reformën e legjislacionit
- Themelimin e komunave të reja;
- Bartjen e kompetencave dhe resurseve;
- Ngritjen dhe zhvillimin e kapaciteteve të komunave;
- Kryerjen e fushatave informuese mbi decentralizimin.

Për të qenë njësi efektive e qeverisjes lokale, një Komunë duhet të përmbush këto kushte:

- Të ketë kufijtë administrativë të përcaktuar qartë;
- Të ketë sistem zgjedhor demokratik që prodhon organe komunale legjitime;
- Të ketë përgjegjësi dhe kompetenca të përcaktuara dhe të garantuara me ligj;
- Të ketë burime të mjaftueshme financiare dhe autonomi financiare për të përmbushur përgjegjësitë e saj;
- Të ketë kapacitete njerëzore dhe administrative për të ushtruar përgjegjësitë dhe për të ofruar shërbimet ndaj qytetarëve.

Sipas Ligjit të ri për Kufijtë Administrativë të Komunave, për shembull në regjionin Prizrenit kemi përbërjen prej pesë komunave dhe një pilot-njësie komunale, e cila në zgjedhjet e fundit ka marrë pjesë në këtë proces dhe pritet të konsolidohet si komunë më vete, me kompetenca të plota.

<sup>11</sup>Po aty fq 4

<sup>12</sup>Po aty fq 2

## Përvojat nga Komunitet e Rajonit të Prizrenit

### Arsimi dhe Edukimi

Ndër kompetencat e qeverisë lokale sipas LVL-së është edhe arsimit parashkollor, çerdhet, arsimi primar dhe sekondar. Ligji për Arsimin në Komunitet i lë në kompetencë të komuniteteve emërimin e drejtorëve dhe menaxhimin e shkollave. Në kuadër të përgatitjeve për bartjen e kompetencave, sipas Planit Strategjik të MAPL-së, ministria është përgjegjëse për ngritjen e kapaciteteve humane dhe infrastrukturore. Nga zyrtarët e Drejtorisë për Arsim në Komunitet e Prizrenit konfirmohet se bartja e kompetencave po bëhet gradualisht mirëpo mungesa e ekspertizës së mirëfilltë ka bërë që të këtë ngecje në këtë drejtim. Ngritja e kapaciteteve njerëzore në këtë drejtori ka filluar, megjithatë duhet një intensitet më i lartë për të rritur gatishmërinë e stafit për sfidat e reja. Nga ana e kësaj Drejtorie gjithashtu është potencuar se nga vitit i ardhshëm do të këtë një decentralizim në menaxhimin e shkollave nga autoritetet lokale, përfshirë administrimin e financave përkatëse në shkolla.

Në Komunitet e Rahovecit dhe atë të Dragashit, sfidë për institucionet lokale mbeten strukturat paralele në nivel të organizimit të shkollave. Derisa qeveritë lokale në këto komuna bëjnë përpjekje të bashkëpunojnë me udhëheqësit e shkollave të paraleleve serbe (të cilat aktualisht punojnë me plan-programe serbe, ndërsa paguhen edhe nga burimet e Buxhetit Shtetëror të Kosovës<sup>13</sup>), stafi menaxhues i këtyre shkollave nuk kanë as kontratë me autoritetet përkatëse kosovare, mirëpo akoma figurojnë në listën e pagave dhe marrin pagat rregullisht. Duke qenë se ky është problem politik që nuk mund të zgjidhet nga komunitet individuale, MASHT, është në proces të hartimit të plan-programit arsimor të Kosovës në gjuhët e minoriteteve, gjë që pritet t'i shpërbëjë këto struktura paralele përmes integritit gradual të të gjitha komuniteteve minoritare në sistemin arsimor të Kosovës.

Procesi i decentralizimit lidhet drejtpërsëdrejti me komunitetin lokal dhe për këtë arsye kërkon bashkëpunim, praninë dhe pjesëmarrje të të gjitha komuniteteve në Kosovë, në veçanti të komunitetit serb<sup>14</sup>. Për të dalë nga kjo gjendje duhet të shqyrtohen dy mundësi: detyrimi ligjor për këto struktura apo edhe të formohet një skemë e veçantë pagash për këta punonjës dhe të rikthehen nën autoritetin ligjor të institucioneve vendore.

Objektet arsimore publike mund të ndërtohen nga komuna dhe të financohen nga buxheti i komuniteteve dhe donacionet. Kompetencat komunale në ndërtimin e objekteve arsimore përfshijnë identifikimin e nevojave për ndërtimin e objekteve arsimore, përcaktimin e vendndodhjes së objekteve dhe ofrimin e tokës komunale, përgatitjen e planit të implementimit, projektimin e objektit, dhënien e lejes së ndërtimit, prokurimin e shërbimeve dhe materialeve të ndërtimit, inspektimet e nevojshme, dhënien e lejeve përfundimtare për vënie në përdorim të objektit dhe krijimin e kushteve normale për procesin e arsimimit dhe trajnimit. Komuna duhet të paraqesë konfirmimin për disponueshmërinë e tokës komunale për ndërtim, planin e implementimit të pro-

<sup>13</sup> Intervistë me zyrtarë të Komunitet të Rahovecit dhe Komunitet të Dragashit

<sup>14</sup> Implementimi i Procesit të Decentralizimit në Kosovë një vit pas Kushtetutës, Prishtinë, qershor 2009

## Decentralizimi në Kosovë:

jektit dhe projektin përfundimtar të shkollës jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë para datës së planifikuar për fillimin e prokurimit për shërbimet e ndërtimit. Shkollat do të kenë buxhetin e tyre të ndare nga Komuna<sup>15</sup>.

Problematikë në veti mbetet mos gatishmëria e Ministrive përkatëse për inkorporimin e projekteve kapitale të hartuara nga qeveritë lokale si dhe mungesa e stafit në nivel të drejtorive të shkollave për analizimin e kostove për bartjen e financave në nivel të shkollave, gjë që është kryekëput pasojë e mungesës së trajnimeve për ngritjen e kapaciteteve dhe burimeve njerëzore<sup>16</sup>.

Lidhur me arsimin, janë identifikuar gjithsej gjashtë fusha problematike me të cilat përballet Komuna e Prizrenit:

1. Hapësira të pamjaftueshme dhe të shëndetshme për mësimdhënie dhe të nxënë;
2. Përfshirja e pamjaftueshme e fëmijëve në sistemin e arsimit në të gjitha nivelet e arsimit në kompetencë të Komunës;
3. Performanca jo e mjaftueshme për qeverisje, udhëheqje dhe menaxhim të arsimit në komunë;
4. Cilësia jo e kënaqshme e mësimdhënies dhe të nxënës;
5. Bashkëpunim i mangët në mes të organizatave dhe institucioneve relevante; dhe
6. Mungesa e kushteve për zhvillim të arsimit profesional<sup>17</sup>.

Specifikë në Rajonin e Prizrenit është se mësimi zhvillohet në katër gjuhë mësimore: shqip, boshnjakisht, turqisht dhe serbisht. Përderisa në komunën e Prizrenit mësimi zhvillohet në tri gjuhë mësimore (shqip, boshnjakisht dhe turqisht), në komunën e Rahovecit dhe atë të Dragashit kjo bëhet në dy gjuhë gjuhë (shqip dhe serbisht).

Sistemi arsimor në Kosovë vazhdon të vuan nga mungesa e burimeve njerëzore, mungesa e objekteve adekuate (përfshirë shërbimet bazike sanitare dhe ujë të pijshëm të mjaftueshëm dhe adekuat), kualiteti i dobët i mësimdhënies dhe niveli i ulët i përfshirjes në sistemin arsimor (më i ulët së mesatarja e rajonit). Implementimi i Ligjit për Arsim në nivelin lokal pengohet për shkak të mungesës së kapaciteteve të duhura financiare dhe administrative të Drejtorive komunale të Arsimit. Përqindja e lënies së shkollimit është më e lartë së mesatarja e rajonit, dhe mungesa apo vonesa e mësimdhënësve është një çështje shqetësuese. Pjesëmarrja apo përfshirja në zhvillimin e fëmijërisë së hershme jo të detyruar dhe në arsimin e lartë e aftësim është ndër më të ulëtat në Evropë. Ende mungon një mekanizëm për monitorimin e cilësisë së mësimdhënies<sup>18</sup>.

<sup>15</sup>Ligji për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës

[http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008\\_03-L068\\_al.pdf](http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008_03-L068_al.pdf)

<sup>16</sup>Intervistë me zyrtarë të Komunës së Suharekës

<sup>17</sup>Plani Zhvillimor i Drejtorisë së Arsimit për Periudhën 2009 – 2011, Komuna e Prizrenit

<sup>18</sup>Raporti i Progresit i Komisionit Evropian për Kosovën, Bruksel, tetor 2009, e <http://www.acdei-ks.org/administrimi/uploads/files/Raporti%20i%20Progresit%202009%20i%20KE%20per%20Kosov.en.perkthimi%20zyrtar.pdf>

## Përvojat nga Komunitat e Rajonit të Prizrenit

### Ekonomia dhe Financat

Sipas legjislacionit të ri, komunitat janë përgjegjëse për hartimin e politikave për zhvillim ekonomik dhe të politikave fiskale. Bazuar në Ligjin për Menaxhimin e Financave Lokale komunitat kanë kompetencën dhe pavarësi për të përcaktuar parametrat për të hyrat vetanake lidhur me tatimet në pronën e paluajtshme, tarifatat, ngarkesat dhe gjobat nga shërbimet dhe veprimtaritë komunale.

Si sukses i decentralizimit deri më tani ka qenë bartja e zyrës së thesarit në nivel të përgjegjësisë së komunitave,<sup>19</sup> në kuadër të menaxhimit të shpenzimeve të financave publike si dhe qasja direkt në sistemin informativ në menaxhimin financiarë (free balance)<sup>20</sup> përfshirë edhe trajnimin dhe certifikimin e stafit.

### Pavarësia Financiare e Komunitave

Në përputhje me politikat ekonomike kombëtare, dhe duke pasur parasysh qëndrueshmërinë fiskale të komunitave dhe Qeverisë, komunitat kanë të drejtë të kenë burime të mjaftueshme financiare me të cilat mund të disponojnë lirshëm gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre komunale në përputhje me ligjet e zbatueshme në vend. Për të mirë të popullsisë së komunitës, Kuvendet Komunale dhe zyrtarët ekzekutivë të tyre kanë të drejtën dhe autorizimin që në mënyrë të pavarur t'i rregullojnë dhe menaxhojnë burimet financiare të cilat rrjedhin nga të hyrat vetanake komunale ose të cilat i janë ndarë komunitës në formë të grantit të përgjithshëm si burime vetanake të komunitave për financimin e përgjegjësive të tyre.<sup>21</sup>

Në kuadër të kompetencave të shtuara, akoma nuk është arritur të delegohet kompetenca për regjistrimin e bizneseve nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë tek Komunitat. Në mungesë të kësaj kompetence, qeveritë lokale përballen me mungesën e të dhënave për bizneset dhe shumë nga të dhënat e ministrisë korrespondojnë me biznese fiktive, gjë që vështirëson më tej punën e autoriteteve komunale për ekonomi dhe financa në arkëtimin e taksave nga këto biznese si të regjistruara, gjë që rezultojnë në akumulim borxhesh.<sup>22</sup> Në këtë kontekst, në Komunitën e Suharekës dhe atë të Dragashit në vitin e ardhshëm Banka Botërore do të implementojnë një projekt mbështetës. Përmes këtij projekti synohet që Komunita të bëhet urë lidhëse në mes të Ministrisë përkatëse dhe qytetarëve, gjë që do t'u mundësojë qytetarëve të regjistrojnë bizneset e tyre nëpër komunitat përkatëse e jo në ministri, siç ka qenë deri më tani.<sup>23</sup>

<sup>19</sup> Intervistë me zyrtarë të Komunitave në rajonin e Prizrenit

<sup>20</sup> Intervistë me zyrtarë të Komunitës së Suharekës

<sup>21</sup> Ligji për Menaxhimin e Financave Lokale, Neni 2,

[http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008\\_03-L049\\_al.pdf](http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008_03-L049_al.pdf)

<sup>22</sup> Intervistë me zyrtarë të Komunitës së Prizrenit

<sup>23</sup> Intervistë me zyrtarët në Komunitën e Suharekës

## Decentralizimi në Kosovë:

## Shërbimet Publike

Komunat kanë kompetencë për ofrimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve publike dhe shërbimeve komunale, përfshirë furnizimin me ujë, kanalizimin dhe drenazhin, trajtimin e ujërave të zeza, menaxhimin e mbeturinave, rrugëve lokale, transportit lokal dhe skemave të nxehjes lokale. Qytetarët vënë në pah se akoma ka konfuzion në lidhje me atë se kush është përgjegjës për ofrimin e shërbimeve komunale.<sup>24</sup> Përderisa LVL specifikon se Komuna është kompetente për kryerjen e shërbimeve të lartcekura, Ligji mbi Ndërmarrjet Publike u lejon NP-ve të menaxhojnë me këto kompetenca. Zyrtarët komunalë shprehen të indinjuar me këtë, ngase qytetarët adresohen me ankesa tek komuna e jo në NP dhe kërkojnë që urgjentisht të fillohet në harmonizimin e legjislacionit, ngase këtu kemi të bëjmë me konflikt ligji (kompetencë e dyfishtë për të njëjtin shërbim).<sup>25</sup>

Siç është theksuar nga autoritetet e Komunave të rajonit të Prizrenit, aktualisht shumica nga e shërbimeve publike në komuna menaxhohen nga kompanitë rajonale, të cilat nuk i përgjigjen komunave, prandaj gjendja në këtë drejtim është e pakënaqshme, sidomos sa i përket ujërave dhe mbeturinave. Sipas tyre, qytetarët kërkojnë llogaridhënie nga udhëheqja e komunës për problemet më të cilat ata ballafaqohen, ndërsa komuna është e pafuqishme për të ofruar zgjidhje për problemet e tyre, ngase është e zhveshur nga kompetencat të cilat i takojnë apo do të duhej t'i takonin. Në këtë kontekst, duhet të identifikohen personat përgjegjës për gjendjen e krijuar që prej shumë kohësh në fushën e shërbimeve publike, në mënyrë që të dihet se kush është fajtor për këtë gjendje sa i përket menaxhimit të shërbimeve publike komunale. Sipas tyre, gjithashtu ka probleme edhe sa i përket mbeturinave të ngurta, të cilat gjithashtu menaxhohen nga një kompani rajonale, me të cilat janë vërejtur probleme sa i përket koordinimit në mes kësaj të fundit dhe autoriteteve përkatëse komunale, madje zyrtarët komunalë pohojnë se akoma nuk janë vendosur kontakte mes tyre dhe këtyre kompanive rajonale. Në këtë kontekst bie edhe problemet që lidhen me deponitë e mbeturinave në territorin e komunës.

Ndër alternativat për evitimin e problemit të ligjshmërisë së kompetencave është thënë se "Asociacioni i Komunave duhet të iniciojë procedurë gjyqësore në gjykatën kushtetuese për vlerësimin e kolizionit në mes të LVL-së dhe LNP-së"<sup>26</sup>.

## Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale

Sipas legjislacionit në fuqi, kujdesi primar shëndetësor dhe mirëqena sociale janë në përgjegjësi të plotë të qeverive lokale<sup>27</sup>. Sipas LVL, komunat janë përgjegjëse për sigurimin e ofrimit të kujdesit parësor shëndetësor si dhe ndjekjen e gjendjes shëndetësore të qytetarëve në territorin e tyre, duke zbatuar me përparësi masat parandaluese. Sa i përket formës së organizimit, ky ligj specifikon se kujdesi parë-

<sup>24</sup>Mozaiku i Kosovës 2009

<sup>25</sup>Intervistë me zyrtarët komunalë dhe Kryetarin e Komunës së Suharekës

<sup>26</sup>Intervistë me Kryetarin e Komunës së Suharekës

<sup>27</sup>Ligji për Vetëqeverisje Lokale, [http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2004\\_4\\_al.pdf](http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2004_4_al.pdf)

## Përvojat nga Komunitat e Rajonit të Prizrenit

sor shëndetësor zbatohet përmes shërbimeve të mjekësisë familjare dhe përfshin:

- Përparimin, parandalimin, mjekimin, shërimin dhe rehabilitimin që kanë të bëjnë me sëmundjet, çrregullimet dhe lëndimet;
- Edukimin shëndetësor, imunizimin dhe vaksinimin;
- Përcaktimin e diagnozës fillestare dhe kujdesin elementar shëndetësor, përfshirë ndërhyrjet e vogla kirurgjike;
- Promovimin e shëndetit oral dhe kujdesin themelor stomatologjik;
- Kujdesin për shëndetin mendor të bazuar në bashkësi;
- Rehabilitimin e bazuar në bashkësi;
- Sigurimin e ujit dhe ushqimit cilësor.<sup>28</sup>

Organizata Botërore e Shëndetësisë e përkufizon Kujdesin Parësor Shëndetësor (KPSH) si “kujdes shëndetësor esencial në të cilin kanë qasje universale individët dhe familjet në komunitet në mënyra të pranueshme për ta, përmes pjesëmarrjes së plotë të tyre dhe me një kosto që mund të mbulohet nga komuniteti dhe shteti. Ai përbën një pjesë integrale të sistemit shëndetësor të shtetit, në të cilin është bërthama, si dhe të zhvillimit të përgjithshëm social dhe ekonomik të komunitetit”. Komunitet sigurojnë zbatimin e kujdesit parësor shëndetësor duke i dhënë përparësi zbatimit të masave parandaluese përmes implementimit të konceptit të mjekësisë familjare. Kosova është e ndarë në 36 Komuna, ku janë të vendosura institucionet e KPSH-së, respektivisht Qendrat Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF). Përveç QKMF-ve, në mesin e institucioneve që ofrojnë kujdes parësor shëndetësor bëjnë pjesë dhe Qendrat e Mjekësisë Familjare (QMF) dhe Punktet e Mjekësisë Familjare (PMF). Në komunitet ku mungon qasja e lehtë në spitale, në kuadër të disa QKMF-ve ekzistojnë edhe maternitetet jashtë-spitalore si dhe Qendrat për Mirëqenien e Gruas (QMG). Qendra e Mjekësisë Urgjente planifikohet të funksionoj në Komunitet me më tepër se 150.000 banorë<sup>29</sup>.

Sa i përket kujdesit shëndetësor primar qytetarët vazhdojnë të përballen me vështirësi të mëdha, përfshirë infrastrukturën e varfër, mungesën e barërave esenciale në qendrat e mjekësisë familjare, shërbime jo të efektshme, pa hyrë në çështjen e rregullimit dhe të kontrollimit të sektorit privat të shërbimeve mjekësore. Po ashtu vështirësitë hasen në vendosjen dhe menaxhimin e një sistemi të sigurimeve shëndetësore gjë që përbën bazën e normalizimit të shërbimeve mjekësore.

Në kuadër të Drejtorive për Shëndetësi si bartje e kompetencave ka kaluar edhe Qendra për Punë Sociale mirëpo mbetet akoma problem forma e përzgjedhjes të atyre që kanë nevojë për ndihma, duke aluduar në kushtet e pafavorshme dhe të koklavitura në ata që kanë nevojë për ndihma. Në aspektin formal ka kaluar buxheti ndërsa në aspektin praktik e dirigjon ministria gjegjëse .

<sup>28</sup>Ligji për Shëndetësi neni 28 [http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2004\\_4\\_al.pdf](http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2004_4_al.pdf)

<sup>29</sup>Strategjia Sektoriale e Shëndetësisë 2010-14 <http://www.mshgov-ks.org/strategjia.pdf>

<sup>30</sup>Intervistë me Kryetarin e Komunitet të Malishevës

## Decentralizimi në Kosovë:

## Planifikimi Rural dhe Urban

Kompetencë e komunës është edhe planifikimi urban dhe rural, përfshirë hartimin e Planeve Zhvillimore Komunale, Planeve Zhvillimore Urbane dhe Planeve Rregullative Urbane<sup>31</sup>. Nevoja për një qasje më ndryshe në planifikimet urbanistike akoma mbetet problematike në veti. Në këtë kontekst, për qeveritë lokale në Rajonin e Prizrenit mbetet sfidë planifikimi urban dhe rural, ku gjendja aktuale është alarmante, dhe karakterizohet me shumë ndërtime të egra, pa përfillur kriteret urbanistike. Sipas Ligjit për Planifikim Hapësinor, autoritetet përgjegjëse për zbatimin e planeve hapësinore janë: Kuvendi i Kosovës, Qeveria e Kosovës dhe Kuvendet Komunale, këto të fundit në kuadër të kompetencave komunale.<sup>32</sup>

Me qëllim të ofrimit të këshillave profesionale në procesin e hartimit të planeve zhvillimore komunale, planeve zhvillimore urbane, sipas zyrtarëve të Komunave të Rajonit të Prizrenit kanë deklaruar se si pikë mbështetëse në këtë drejtim ka dhënë UN-Habitati i cili ka ndihmuar në ngritjen e kapaciteteve të planerëve lokal. Në këtë kontekst tepër shqetësues mbetet fakti i mos hartimit të Planeve Zhvillimore Komunale ku si domosdoshmëri duhet të investohet dhe të ndihmohet nga ana e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë në këtë drejtim<sup>33</sup> si parakusht për hartimin e Planeve Urbanistike dhe Planeve Rregullative Urbane.

## Zhvillimi Ekonomik Lokal

Zhvillimi Ekonomik Lokal është disiplinë holistike dhe mund të definohet si rritje e kapacitetit të ekonomisë lokale për të krijuar pasuri për banorët lokal. Zhvillimi Ekonomik Lokal ka të bëjë me punën e përbashkët të njerëzve dhe krijimin e partneriteteve për të arritur rritje të qëndrueshme ekonomike që sjell përfitime ekonomike dhe përmirësime të cilësisë së jetës të të gjithëve në komunitet. Kjo rritje mund të arrihet nëse resurset lokale (puna, toka dhe kapitali) shfrytëzohen në mënyrë më produktive.<sup>34</sup>

Këto qëllime parashihen të arrihen përmes:

- Promovimit të bizneseve të vogla dhe të mesme lokale;
- Shfrytëzimit të resurseve dhe potencialeve natyrore dhe njerëzore;
- Zbutjen e papunësisë përmes krijimit të vendeve të reja të punës, investimeve të brendshme dhe të jashtme;
- Përmirësimi dhe zhvillimit të infrastrukturës lokale.

Mundësia e komunave në gjendjen ekzistuese ndoshta mundë të jetë në pozitë jo të favorshme sa i përket politikave për zhvillimit ekonomik lokal mirëpo qeveritë lokale duhet të bëjnë përpjekje në hartimin e planeve strategjike për zhvillim lokal

<sup>31</sup>Ligji për Planifikim Hapësinor, Neni 10.2, [http://www.ks.gov.net/mmph/document/shqip/ligje/plan\\_hap/Ligji\\_per\\_plani\\_hapsinor\\_2003\\_14\\_shqip.pdf](http://www.ks.gov.net/mmph/document/shqip/ligje/plan_hap/Ligji_per_plani_hapsinor_2003_14_shqip.pdf)

<sup>32</sup>[http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2003\\_14\\_al.pdf](http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2003_14_al.pdf)

<sup>33</sup>Vetëm disa komuna në rajonin e Prizrenit kanë filluar me hartimin e Planit Zhvillimor Komunal

<sup>34</sup>Asociacioni i komunave të Kosovës, Raporti Vjetor 2008, Prishtinë, dhjetor 2008

## Përvojat nga Komunitet e Rajonit të Prizrenit

në bazë të specifikave të komunave. Si ndihmesë në zhvillimin ekonomik lokal luan edhe krijimi i zonave industriale të cilat kanë mundësinë e gjenerimit të të hyrave vetanake dhe do të kenë implikime direkte në rritjen e numrit të të punësuarve dhe në ngritjen e mirëqenies së qytetarëve në përgjithësi. Komuna e Suharekës ka krijuar zonën industriale dhe kanë filluar të operojnë bizneset e para<sup>35</sup>.

Për këtë qëllim parashihet themelimi i Zyrave komunale për Zhvillim Ekonomik, e cila ka këto detyra:

- Të udhëheq politikat ekonomike lokale;
- Të planifikon zhvillimin e përgjithshëm ekonomik lokal;
- Të përcakton prioritetet zhvillimore dhe strukturale;
- Të përgatit programe dhe propozime të masave për përkrahjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme;
- Të përgatit analiza, të dhëna statistikore dhe raporte periodike mbi nevojat e komunës në këtë fushë;
- Të bashkëpunon me organizata ndërkombëtare dhe shoqata jo-qeveritare që përfaqësojnë qytetarët;
